



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPŠTINA VUČITEN
02 Nr. / Br 1118/21
Nr. i fq. / Br. st _____
Data: / Datum 24.09.2021
VUSHTRRI - VUČITEN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI


Kryetari

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 67, shkronja "g" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe Rregullores MF Nr. 01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **APROVOHET, plotësim/ndryshimi** i kapitullit të III-të "Procesi i kontratave për shërbime me marrëveshje të veçanta", si pjesë përbërëse e Doracakut "**Libri i Proceve për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike**", i cili përmban komponentët/proceset e: buxhetit komunal, menaxhimit të pagave, kontratave për shërbime me marrëveshje të veçanta, shpenzimeve për mallra shërbime, shpenzimeve për avance dhe para të imët, shpenzimeve për udhëtime zyrtare, shpenzimeve për komunalit, shpenzimeve për subvencione dhe transfere, shpenzimeve për investime kapitale, menaxhimit të projekteve, prokurimit dhe menaxhimit të kontratave. **Ky proces i është nënshtruar plotësim/ndryshimit si rezultat i ndryshimeve në kornizën ligjore, ku aktualisht procesi në fjalë rregullohet sipas: Ligjit për Prokurimin Publik 04/L-042, Ligjit për zyrtarët publik 06-L-114, Rregullës për prokurim të Shërbimeve të Veçanta (konsulentët/kontraktorët individual), si dhe Rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik.**
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është versioni i plotësuar/ndryshuar i kapitullit III "Procesi i kontratave për shërbime me marrëveshje të veçanta" të Doracakut "**Libri i Proceve për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike**".
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoritë komunale, dhe Zyrtarët kompetent të Komunës.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Dërgohet: Drejtorëve të drejtorive, Arkivit të Sekretarisë.


Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M

1. Lejohet pagesa e shpenzimeve në shumë prej 425.60 € (katërqindnjëzetepesë euro e gjashtëdhjetë cent) – një racion ditor prej 2 euro, për vullnetarë të Kryqit të Kuq dega në Vushtri të cilët kanë marrë pjesë gjatë muajit gusht 2021 në vaksinimin e popullatës nga pandemia COVID-19 në Komunën e Vushtrisë (punë logjistike rreth mbarëvajtjes së vaksinimit).
2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në llogarinë bankare të Kryqit të Kuq në Vushtri.
3. Faturat për shpenzimet e ushqimit si dhe specifikacionet e konfirmuara nga Kryqi Kuq dega në Vushtri janë bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të kërkesës së KKZ-së nr. 26/2021, dt. 26.08.2021, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet shfrytëzimi i automjetit zyrtar të Komunës së Vushtrrisë me targë 02Z-07-27 për nevoja të Komisionit Komunal Zgjedhor i cili do të përdoret për kryerje të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet lokale që do të mbahen më 17 tetor 2021.
2. Automjeti iu ipet në shfrytëzim nga data 15.09.2021 deri në certifikim të rezultateve zgjedhore lokale në Komunën e Vushtrrisë.
3. Autorizohet z. Betim Xhema, nr. personal 1172183987, kryetar i komisionit komunal zgjedhor që të drejtojë automjetin zyrtar i cili iu ipet në shfrytëzim për nevojat e KKZ-së. Në raste të domosdoshme automjeti mund të përdoret edhe nga ndonjëri nga stafi i KKZ-së.
4. Pas përfundimit të aktivitetit ditor për zgjedhjet, automjeti duhet të kthehet në autoparkun e komunës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Ragip Muzaqi, Shef i autoparkut të komunës dhe z. Betim Xhema, kryetar i KKZ-së në Vushtrri.
6. Vendimi hyn ë fuqi në ditën e nënshkrimit.

Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Shefit të autoparkut të komunës,
- Kryetarit të KKZ
- Arkivit të Sekretarisë.